



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 557/2 Prot.

Tiranë, më 11.11.2022

V E N D I M

Nr. 135, datë 11.11.2022

Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, në lidhje me veprimet e kryera për daljen e vendimit të komandimit nr. 68, (2778 prot.) datë 21.06.2022, “Për riemërimin në punë të ***”, nga kryetari i bashkisë Tropojë.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të verifikimit të informacionit të marrë nga nëpunësja e bashkisë Tropojë, *****,

Vërej se:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është paraqitur një informacion prej nëpunëses ***** i protokolluar me nr. 557 prot., datë 08.07.2022, nëpërmjet të cilit pretendohet se janë lejuar shkelje të ligjshmërisë dhe parregullsi gjatë procedurës për marrjen e vendimit të komandimit nr. 68 (2778 prot.) datë 21.06.2022, “Për riemërim në punë të *****”, nga ana e kryetarit të bashkisë Tropojë.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyron veprimet administrative që janë kryer gjatë kësaj procedure, rezulton se nëpunësja në fjalë, pasi ka zhvilluar konkurrimin, është emëruar me aktin e datës 26.05.2017 (1495/3 Prot.) si nëpunëse civile në periudhë prove. Më tej, pas përfundimit të periudhës së provës, me aktin nr. (2629 prot.) datë 27.05.2018, është konfirmuar si nëpunëse civile në pozicionin “Specialiste e financës dhe arkivimit të dokumentave të financës”.

Konstatohet se, për nevoja të institucionit, me anë të urdhërit nr. 118 (1928 Prot.) datë 14.05.2020, të kryetarit të bashkisë, punonjësja është komanduar në pozicionin “Specialiste

e ndihmës ekonomike, paaftësisë dhe invaliditetit”, në Njësinë Administrative Bujan, në Bashkinë Tropojë, urdhër të cilin ajo e ka zbatuar pa kushte.

Reaulton se në këtë akt, nuk është përcaktuar asnjë afat kohor, por është specifikuar shprehja “deri në një urdhër të dytë”.

Pasi kanë kaluar më shumë se dy vjet, urdhëri i mësipërm është përsëritur me aktin nr. 68 (2778 Prot.) datë 21.06.2022, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë “*Për riemërim në punë të ******”, në të njëjtin pozicion.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura nga nëpunësja dhe analizës së dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit, konstatohet sa më poshtë:

Në dispozitën e nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Nëpunësi civil mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, për këto arsye dhe kohëzgjatje:

a) në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 viteve;

b) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 viteve;

c) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzënisë, në bazë të vendimit të komisionit.

E njëjta gjë, specifikohet edhe në Kreun I, të Vendimit nr. 125, datë 17.12.2016, të Këshillit të Ministrave “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, duke parashikuar se nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, sipas rastit, përkatësisht brenda institucionit ku është emëruar, përfshirë edhe degët e tij territoriale, në një institucion të varësisë së institucionit ku është emëruar, në një institucion tjetër të shërbimit civil: “... *a) Në interes të institucionit, deri në 6 (gjashtë) muaj me/ose pa ndërprerje, gjatë 2 viteve; b) Për përmirësimin e rezultateve të tij, deri në 3 (tre) muaj pa ndërprerje gjatë 2 viteve; c) Për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzënisë, të përcaktuara nga komisioni kompetent në bazë të ligjeve në fuqi, për aq sa është e nevojshme sipas vendimit të komisionit përkatës.*

Nga sa u sqarua më sipër, vlerësojmë se kryetari i bashkisë Tropojë, nëpërmjet aktit me numër 118 (1928 Prot.) datë 14.05.2020, ka urdhëruar lëvizjen në detyrë të nëpunëses në fjalë, duke përdorur një mjet (*komandimin*), i cili nuk njihet nga legjislacioni i shërbimit civil.

Në këto kushte, urdhëri që po shqyrtohet është i paligjshëm, pasi vjen në kundërshtim me ligjin material në drejtimet e mëposhtme:

Së pari, është shkelur kushti i vënë në pikën 1/a, të nenit 48, të ligjit nr.152/2013, sipas të cilit transferimi i përkohshëm bëhet për nevoja të institucionit, por jo më shumë se 6 muaj gjatë dy vjetëve;

Së dyti, ky transferim i parë, jo vetëm është bërë në shkelje flagrante të afateve të vëna në dispozitën e mësipërme, por pas kalimit të një afati prej dy vjetësh është përsëritur shkelja (me aktin nr. 68 (2778.) datë 21.06.2022, “Për riemërim në punë të *****”), duke urdhëruar një komandim tjetër, të paligjshëm, pa afat të përcaktuar, pa respektuar kushtet e kërkuara nga dispozita e sipërpërmendur dhe Kreu I, i Vendimit nr. 125, datë 17.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”.

Konkretisht, sipas vendimit të mësipërm, transferimi i përkohshëm, (në bazë të shkronjës “a”, të pikës 2, të tij), nuk kryhet me akt të drejtuesit të bashkisë, por pas paraqitjes së kërkesës apo propozimit, nga ana e një njësie organizative e cila ka evidentuar nevojën e plotësimit të përkohshëm të pozicionit të punës. Në këtë rast, njësia përgjegjëse vlerëson rrethanat dhe cilësitë e personave të mundshëm për zëvendësim (transferim të përkohshëm), e pas kësaj nxjerr aktin përkatës, duke njoftuar me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Theksohet që, njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kriterëve të pozicionit të punës ku ai kërkohet të transferohet, si dhe në plotësimin e kërkesave të veçanta të përcaktuara në përshkrimet e punës, sipas kriterëve të legjislacionit të shërbimit civil, për të vendosur nëse janë kushtet për të nxjerrë aktin e transferimit.

Nga sa është parashtruar më sipër, arrihet në përfundimin se, në bazë të nenit 109, pika “b” dhe pika “d” të tij, për shkak të shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën administrative, ndodhemi para dy akteve të paligjshëm të kryetarit të bashkisë Tropojë, të cilët duhet të anulohen si të tillë dhe për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, duhet të urdhërohet kthimi i nëpunëses ***** në pozicionin e punës ku ajo ka emërimin e rregullt “Specialiste e financës dhe arkivimit të dokumentave të financës”.

Këto akte, në bazë të pikës 1, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, duhet të anulohen nga vetë organi publik që e ka nxjerrë, me një akt të ri me shkrim, sipas pikës 3, të dispozitës në fjalë.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara, në nenin 2 dhe 4, në pikën 1 të nenit 11; në nenet 14 dhe 15; në pikën 1/a të nenit 48 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; në Kreun I, të Vendimit nr. 125, datë 17.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”; në nenin 109, pika “b” dhe “d”; në pikën 1 dhe 3 të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i

Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 16/8 dhe 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

- 1- Të kërkohet nga ana e organit publik, Kryetarit të Bashkisë Tropojë, që bazuar në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, të anulojë aktin administrativ të riemërimit nr. 68 datë, 21.06.2022 “Për riemërim në punë të *****”, si një akt i paligjshëm, nëpërmjet një akti të ri me shkrim, dhe të rregullojë pasojat, duke e kthyer punonjësen në fjalë në pozicionin e mëparshëm të punës “Specialiste e financës dhe arkivimit të dokumentave të financës”.
- 2- Njësia e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Tropojë, të krijojë të gjitha kushtet e të ndjekë ecurinë e procesit administrativ për zbatimin e detyrave të mësipërme.
- 3- Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat 15 ditë, nga marrja dijani për këtë vendim.
- 4- Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
- 5- Të njoftohet për këtë vendim bashkia Tropojë dhe ankuesja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha